

**AKT THEMELIMI  
(KONTRATË)**

**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"BALLIU-DI"- Sh.P.K.**

Unë, **Albian BALLIU**, lindur me 16.03.1996 në Pjeçë/Diber, banues në Peshkopi, Lagja "Gjok Doçi", Rruga "Dali Ndreu Ndërtesa Nr.18, zotërues i Kartës së Identitetit **nr.personal/personal no. J60316005G**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

Sot me datë **03.07.2017**

**V E N D O S A**

**Neni 1**

Të themeloj një Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike të EMËRTUAR : **"BALLIU-DI" - Sh.P.K.**

**Neni 2**

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

**Neni 3**

**Shoqëria e ka SELINË në Njësinë Administrative Peshkopi, Bashkia/Diber në adresën : Lagjja "Gjok Doçi", Rruga "Tercilo Kardinali", selia në ndërtesën me numër pasurie Nr.13/10-NI, pranë kryqzimit.**

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare dhe t'i suprimojë ato.

**Neni 4**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një kufi të pacaktuar, **mbi 15 vjet.**

**Neni 5**

Kapitali Themelor i Shoqërisë do të jetë **100 000 Lek (Njëqindmijë lek).**

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, **Albian BALLIU.**

Ortaku i Vetëm **Albian BALLIU**, zotëron **100 %** të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga **1 pjesë e vetme (Një kuotë)** me vlerë nominale prej **100 000 Lek (Njëqindmijë lek).**

**Neni 6**

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga Ortaku i Vetëm. Rritja e kapitalit nuk është e kufizuar.

**Neni 7**

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

**Neni 8**

**Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :**

***Prodhimi dhe tregtimi i bukës. Tregtia me shumicë e pakicë dhe import-eksporti për mallra ushqimore, industriale, lëndë të para, pije, orendi shtëpiake, produkte bujqësore e blektorale, fruta, perime, produkte të detit, mishit dhe nënprodukteve të tij, qumështit e nënprodukteve të tij. Hoteleri, turizëm, bar-kafe, restaurant. Transport mallrash brenda e jashtë vendit për vete dhe për të tretë.***

*Albian Balliu*  


#### **Neni 9**

Marëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Ligjit Nr.7961 Dt.12.07.1995”Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **Neni 10**

Ortaku i Vetëm i shoqërisë nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 11**

Shoqëria vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj.

Ortaku i Vetëm Themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

#### **Neni 12**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë, midis punonjësve brenda saj dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëhere ato zgjidhen me rrugë gjyqësore në gjykatën kompetente.

#### **Neni 13**

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit të shoqërisë.

#### **Neni 14**

Pasuria e shoqërisë mund të sigurohet pranë shoqërive të sigurimit duke respektuar ligjet që veprojnë në fushën e sigurimit dhe risigurimit.

#### **Neni 15**

**Organef e Shoqërisë “BALLIU-DI”- Sh.P.K. janë :**

- Asambleja e Ortakëve
- Administratori/ët e Shoqërisë

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

**Administrator** i shoqërisë do të jenë **Z. Alban BALLIU**.

Modalitetet për ndryshimin e Administratorit/ve si dhe kompetencat rregullohen nga **Statuti i Shoqërisë dhe Ligji Nr 9901 Dt.14.04.2008”Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**.

Ky Akt Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

**THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE“**

**“BALLIU-DI”- Sh.P.K.**

**Alban BALLIU**

*Alban Balliu*  


**Tiranë, me 03 Korrik 2017**